



Die Senatorin für Kinder und Bildung · Rembertiring 8-12 · 28195 Bremen

Auskunft erteilt
Landesjugendamt

Për
të gjithë prindërit dhe kujdestarët ligjorë

Bremen, 04.02.2022

Ndryshimet në rregulloren për koronën: Kopshtet dhe qendrat e kujdesit ditor

Të nderuar zonja dhe zotërinj,
të dashur prindër ose kujdestarë ligjorë,

me këtë letër dua t'ju informoj për ndryshimet në Rregulloren e 30-të të koronës në lidhje me ambjentet e kopshteve dhe kujdesit ditor. Ka të bëjë me kujdesin e fëmijëve tuaj në qendrat e kujdesit ditor dhe kopshtet. Këto ndryshime synojnë të parandalojnë që fëmijët të karantino-hen për periudha të gjata kohore. Rregullat hyjnë në fuqi me publikimin e Rregullores për koronën dhe për këtë arsye duhet të zbatohen duke filluar nga data 7 shkurt 2022.

Në parim, rregullat e mëposhtëme do të zbatohen nga tani për fëmijët tuaj:

1. Nëse fëmija juaj ka korona, ai duhet të izolohet në shtëpi.
2. Fëmija juaj nuk duhet të bëjë më karantinë nëse ka pasur kontakt me një person në kopësht/qendrat e kujdesit ditor (TaPs) i cili ka rezultuar pozitiv me korona. Fëmija juaj mund të vazhdojë të shkojë në kopësht.
3. Qendra e kujdesit ditor/TaPs do t'ju informojë nëse ka një rast pozitiv në grupin e fëmijës suaj (vetëtestimi në grup ose në shtëpi).
4. Më pas vlen menjëherë: Fëmija juaj duhet të testohet negativ çdo ditë për 5 ditë me rradhë.
5. Nëse shumë fëmijë (20%) në grup kanë rezultuar pozitivë, kopshti nuk do të zhvillohet për 5 ditë.
6. Masat shtrënguese mund të përfundojnë para kohe nëse pas rezultateve positive të vetëtestimit do të dalin rezultate negative nga teste të bëra në një qendër testimi.

- *Testimi falas nëse fëmija juaj ka korona:*

Ju mund të testoni lirisht fëmijën në një qendër testimi që nga dita e 7-të. Testi mund të jetë një test i shpejtë ose një test PCR. Të dyja testet duhet të jenë bërë në një qendër testimi. Është i mundur edhe një test nga pediatri. Pa një test, izolimi përfundon të paktën në ditën e 10-të.

- *Nëse një fëmijë tjetër ka një rezultat pozitiv të testit:*

Ju do të informoheni nga qendra e kujdesit ditor/TaPs se në grupin e fëmijës suaj, dikush ka rezultuar pozitiv

Fëmija juaj nuk duhet më të karantinohet automatikisht. Kjo do të thotë se mund të vazhdojë të vizitojë kopshtin. Kusht paraprak është që ta testoni fëmijën tuaj çdo ditë për 5 ditët në vijim të kopshtit (p.sh. e hënë-e premte ose e martë-e hënë) me një vetëtestim ose me një test në qendrat e testimit. Si rregull, testi bëhet në qendrat e kujdesit ditor nëse qendra e ofron këtë. Nëse ju dëshironi të testoni në shtëpi, institucioni do të vendosë për llojin e provës së besueshme. Për shembull ky mund të jetë edhe detyrimi për të paraqitur testin. Nëse rezultati është negativ, fëmija juaj mund të shkojë në kopsht.

Ju nuk keni pse ta testoni fëmijën tuaj çdo ditë nëse fëmija juaj konsiderohet si i vaksinuar ose i shëruar në përputhje me Rregulloren për Përrjashtimit nga Masat mbrojtëse ndaj COVID-19 (§2 numër 2,4).

- *Shpërthimi në Kopshte/TaPs*

Nëse 20 përqind e një grupi rezulton pozitiv (p.sh. 4 fëmijë nga një grup prej 20 fëmijësh), kujdesi për grupin do të pezullohet për 5 ditë. Kjo nuk vlen për fëmijët që janë shëruar ose janë vaksinuar ose nuk kanë qenë në kopësht në kohën kur rezultatet e testit ishin pozitive.

- *Fëmijët e shëruar dhe të vaksinuar*

Fëmijëve të shëruar dhe të vaksinuar u kërkohet ende të testohen, por sipas Rregullores për Koronën ata nuk janë detyruar ta bëjnë këtë.

- *Fëmija juaj ka kontakt në jetën private me një person të infektuar:*

Nëse fëmija juaj ka pasur kontakt privat me një person me korona, rregullat e mësipërme nuk do të zbatohen. Më pas fëmija juaj do të shkojë në karantinë. Duhet të respektohen udhëzimet e autoritetit shëndetësor përkatës.

- *Shërbimet e urgjencës në qendrat e kujdesit ditor*

Në këtë pikë dëshiroj të theksoj dhe të kërkoj mirëkuptimin tuaj se edhe nëse rregullat e karantinës për fëmijët janë zbutur, kjo nuk do të thotë automatikisht se fëmijët tuaj mund të ketë përkujdesje në mënyrë tërësore.

Edhe punonjësit e qendrës së kujdesit ditor mund të infektohen me korona edhe nëse janë vaksinuar 3 herë. Prandaj mund të ndodhë që fëmija juaj mund të ketë përkujdesje pjesërisht ose jo në masën e dëshiruar sepse punonjësit janë sëmurë.

Gjithë të mirat
Përgjegjës

Thomas Jablonski
- Përgjegjës i departamentit për edukimin në fëmijërinë e hershme-